



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

Në kuptim të nenit 12 pika c, të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen e lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008"), neni 43 pika 3 e Rregullores Financiare dhe Udhëzimit Financiar 02-Shpenzimi i Parave Publike, Udhëzimit Administrativ Nr. 2005/08 MEF-it, Klasifikimi ekonomik i shpenzimeve dhe neni 9 të Statutit të Komunës së Pejës 01.Nr :09-8103 të datës 29 shtator 2008, Kuvendi i Komunës së Pejës në mbledhjen e mbajtur me datë: 06 Mars 2013, miratoi këtë:

**RREGULLORE
PËR
NDARJEN E MJETEVE TRANSFERE DHE SUBVENCIONE**

I. DISPOZITAT E PËRGJTHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

1.1. Me këtë rregullore përcaktohen kriteret dhe procedura e ndarjes së mjeteve të buxhetit të komunës – fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale, entiteteve publike dhe jopublike

1.2. Bazuar në fondin e ndarë buxhetor për transfere dhe subvencione për vitin aktual, Kryetari i Komunës, sipas kërkesave të arsyetuara të palëve, aprovon mjete financiare buxhetore - ndihmë momentale, për entitete publike dhe jopublike në shumën e përcaktuar me këtë rregullore.

Neni 2

Ndihmë momentale sipas kësaj rregullore konsiderohet ndihma e menjëhershme në të gatshme që propozohet nga komisioni përkatës i formuar me Vendim të Kryetarit të Komunës.

Ndihmë momentale për entitet publike (institucionet joprotabile)

Neni 3

Ndihma momentale për entitet publike (institucionet joprotabile) përfshinë mbështetjen financiare që u ipet institucioneve kulturore, sportive dhe jo qeveritare, ku nuk kërkohet asgjë specifike si kthim për këto pagesa.



Neni 4

4.1 Kërkesat e etniteteve publike për subvencione duhet ti drejtohen Kryetarit të Komunës përmes zyrës së pranimit.

4.2 Kërkesa duhet të jetë e kompletuar me dokumentacionin mbështetës si :

- certifikata e regjistrimit,
- arsyetimi i kërkesës me provë të qartë dhe bindëse si dhe
- numri i llogarisë bankare të entitetit publik.
- informatë vjetore mbi aktivitetin dhe qarkullimin financiar (e re).

4.3 Përfituesi nga mjetet transfere dhe subvencione mund të përfitoj vetëm një herë brenda vitit buxhetor.

Neni 5

Kryetari i komunës pas pranimit të kërkesës, autorizon Drejtorinë përkatëse të jep mendim profesional për përfituesit në afat prej 15-ditësh. Pas shqyrtimit të kërkesës drejtoria përkatëse i propozon Kryetarit të Komunës për aprovim kërkesat e justifikuara dhe të dëshmuara me dokumentacionin përcjellës.

Subvencionet për entitet jopublike (familje dhe individ)

Neni 6

Në raste urgjente të fatkeqësive të ndryshme natyrore, varfëri të skajshme për familje apo individ të caktuar për banorët e Komunës së Pejës, sëmundjes së rëndë që kërkojnë mjekim të kushtueshëm, kryetari i komunës sipas kërkesave të arsyetuara ndan ndihmë momentale nga fondi për transfere dhe subvencione të Komunës.

Neni 7

Kryetari i Komunës lejon ndarjen e subvencioneve për entitete publike dhe jopublike.

Neni 8

Ndihmat momentale nga fondi për transfere dhe subvencione përjashtohen transfere për qëllime kapitale d.m.th për qëllim të mundësimit që përfitues të përvetësoj pasuri kapitale.



Neni 9

Subvencionet (mjetet nga fondi për transfere dhe subvencione) janë pagesa të njëanshme jo të kthyeshme, për institucionet jofitimprurëse familje dhe individ.

Neni 10

Kriteret që duhet të plotësohen për të qenë përfitues i kësaj ndihme :

- Sëmundja e rëndë e konstatuar me dokumentacionin mjekësorë të specialistit ;
- Gjendja e rëndë ekonomike – familjare e vërtetuar ;
- Dëshmia e shpenzimeve mjekësore dhe shpenzimeve të tjera dhe
- Dëshmia për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë elementare.

Neni 11

Kërkesë për ndihmë momentale mund të paraqesin vetëm personat që janë banorë të përhershëm të Komunës së Pejës.

Organi kompetent për shqyrtimin e kërkesave

Neni 12

12.1. Kompetent për shqyrtimin e kërkesave të entiteteve jopublike për ndihmën momentale është Komisioni i formuar nga Kryetari i Komunës. Ky komision ka për detyrë që të shqyrtojë kërkesat me dokumentacion të kompletuar dhe propozon ndihmë momentale.

12.2. Në përbërje të komisionit janë: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.

12.3. Kërkesat e pakompletuara, Komisioni nuk do ti procedoj me tutje.

12.4. Kërkesat që nuk i plotësojnë kriteret për ndihmën momentale do të refuzohen nga Kryetari i Komunës me propozim të Komisionit.

Neni 13

Shuma e ndihmës momentale për entitete jopublike propozohet nga Komisioni dhe personi i caktuar mund të ndihmohet vetëm një herë në vitë me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme.



Neni 14

14.1 Komisioni, listën e specifikuar të propozuar për ndihmë momentale ja dorëzon Kryetarit të Komunës, i cili ka mundësi ta ndryshojë para se te propozohet për miratim, duke potencuar arsyetimin për ndryshime.

14.2 Kërkesa duhet të shqyrtohet dhe ndihma të kryhet në afatin sa me të shkurtë të mundshëm e jo më larg se 30-ditë.

II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 15

Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset Kryetari i Komunës, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Pejës.

Neni 16

Në raste konflikti të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe dispozitave Rregullave Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit 02-Shpenzimi Parave Publike dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 2005/08 MEF-it Klasifikimi ekonomik i shpenzimeve, do të aplikohen dispozitat e këtyre te fundit.

Neni 17


Hyrja ne fuqi

Kjo rregullore hynë në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Komunës dhe nënshkrimit nga Kryesuesi/ja e Kuvendit të Komunës.

01.06 - 810

Datë 06 Mars 2013

KUVENDI KOMUNAL PEJË



KRYESUESJA
Dr. Arbëresha Ajdini Nallbani



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12 paragrafi 1 pika c) të Ligjit Nr.03/L – 030 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28. datë: 04.qershor 2008), nenit 9 paragrafi 1. pika d) të Statutit të Komunës së Pejës, 01.Numër: 09 – 8103 datë: 29 shtator 2008, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 06. Mars 2013, pas shqyrtimit të Rregullorës për Ndarjen e Mjeteve për Transferre dhe Subvencione, pas procedurës së diskutimit publik, me shumicë votash muar këtë:

V E N D I M

I. MIRATOHET dhe ipet në implementim Rregullorja për Ndarjen e Mjeteve për Transfere dhe Subvencione.

II. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet e Financa e KK.Pejë.

III. Vendimi hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvend Komunal.


IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja për Ndarjen e Mjeteve për Transfere dhe Subvencione.

V.Vendimi ti dërgohet: Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Buxhet e Financa të KK.Pejë, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe një kopje i bashkangjitet Proceverbalit nga takimi i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me datë: 06. Mars 2013.

I.Numër: 06 – 1345/5

Pejë, datë: 06.mars 2013.

KUVENDI KOMUNAL PEJË



KRYESUESJA,
Dr. Arbëresha Ajdini Nallbani